

UDHËZUES PËR MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RISQET E LIDHURA ME RREZATIMIN OPTIK NË VENDIN E PUNËS

Ky udhëzues ka për qëllim të ju ndihmojë punëdhënësve dhe punëmarrësve të kuptojnë rreziqet nga rrezatimi optik dhe masat e duhura për mbrojtje në vendin e punës. Ai synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi rreziqet që lidhen me rrezatimin optik në ambientin e punës, si dhe të sugjerojë disa hapa konkretë që mund të ndërmerren për t'i identifikuar dhe shmangur këto rreziqe.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,

Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI.....	3
LEGJISLACIONI LIDHUR ME MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RISQET E LIDHURA ME RREZATIMIN OPTIK NË VENDIN E PUNËS.....	4
DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT NË MBROJTJEN E TË PUNËSUARËVE NGA RISQET E RREZATIMIT OPTIK.....	4
MASAT EMERGJENTE NË RAST TË EKSPONIMIT AKSIDENTAL NDAJ RREZATIMIT OPTIK.....	8
DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË TË PUNËSUARIT PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMI OPTIK.....	10
AUDITIMET.....	10
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	11
SHTOJCA 1: SHEMBUJ TË FAKTORËVE TË RREZIKUT NGA RREZATIMI OPTIK.....	12



HYRJE

Punëdhënësit kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe mbrojtës për punëtorët e tyre. Përveç sigurimit të kushteve fizike të përshtatshme dhe pajisjeve të nevojshme për punë të sigurt, është thelbësore të menaxhohet ekspozimi ndaj rrezatimit optik, duke përfshirë dritën lazer, rrezatimin ultraviolet (UV) dhe infra të kuqe (IR), për të parandaluar ndikimet negative në shëndetin e syve dhe të lëkurës.

Rrezatimi optik i pakontrolluar mund të shkaktojë dëmtime akute ose kronike të shëndetit të punëtorëve, duke ndikuar jo vetëm në mirëqenien fizike, por edhe në performancën dhe produktivitetin e tyre. Menaxhimi i rrezatimit optik është i domosdoshëm për të siguruar një ambient pune të shëndetshëm dhe për të parandaluar pasoja të padëshiruara si dëmtimet e syve, irritimet e lëkurës apo lodhja e tepërt.

Ky udhëzues synon të ndihmojë punëdhënësit dhe punëtorët, duke ofruar informacione dhe strategji për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga rrezatimi optik në vendin e punës. Përfshihen metoda për kufizimin e ekspozimit, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe krijimin e një kulture organizative që promovon sigurinë, mirëqenien dhe efikasitetin në punë.

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky udhëzues synon të përcaktojë masat minimale për mbrojtjen e punëtorëve nga rrezatimi optik në vendin e punës, duke u fokusuar në parandalimin e efekteve negative në sy dhe lëkurë.

Ai zbatohet për të gjitha vendet dhe aktivitetet ku punëtorët janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj rrezatimit optik, pa marrë parasysh llojin e organizatës, pronësinë apo natyrën e punës.

Qëllimi është të ndihmojë në ndërtimin e një ambienti pune të sigurt dhe të shëndetshëm, ku punëtorët janë të mbrojtur nga rreziqet e rrezatimit optik dhe ku menaxhimi i këtyre rreziqeve lehtëson parandalimin e dëmtimeve ose efektet afatgjata në shëndet. Udhëzuesi inkurajon zhvillimin e një kulture organizative që favorizon identifikimin dhe trajtimin e hershëm të rreziqeve, duke përfshirë përdorimin e masave teknike, organizative dhe personale të mbrojtjes.

Bazuar në praktikrat dhe standardet e rekomanduara për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë, udhëzuesi thekson rëndësinë e masave parandaluese për përmirësimin e sigurisë, ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së punëtorëve, në afat të gjatë kohor.



LEGJISLACIONI LIDHUR ME MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RISQET E LIDHURA ME RREZATIMIN OPTIK NË VENDIN E PUNËS

Legjislacioni i mëposhtëm zbatohet dhe duhet të merret parasysh kur planifikoni çdo lloj aktiviteti lidhur me mbrojtjen e të punësuarëve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës:

- Ligji Nr. 04/L-161, për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2013. (<https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>)
- Rregullore MPMS, NR. 09/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës. (<https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15794>)
- Direktiva 2006/25/EC e BE-së për rrezatimin optik artificial (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32006L0025>)

DETYRIMET E PËRGGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT NË MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RISQET E RREZATIMIT OPTIK

Punëdhënësit kanë përgjegjësi kryesore për mbrojtjen e punëtorëve nga rrezatimi optik dhe për krijimin e një ambienti pune të sigurt. Këto detyrime përfshijnë:

1. Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve: Të identifikojnë burimet e rrezatimit optik në vendin e punës dhe të vlerësojnë rrezikun për shëndetin e punëtorëve, duke përfshirë efektet në sy dhe lëkurë.

2. Parandalimi dhe zvogëlimi i ekspozimit: Të vendosin masa teknike, organizative dhe personale për të reduktuar ekspozimin ndaj rrezatimit optik dhe të sigurojnë pajisje personale mbrojtëse (p.sh. syze, rroba mbrojtëse) sipas natyrës së rrezikut.

3. Sigurimi i trajnimeve dhe informimit: Të ofrojnë trajnime për punëtorët mbi rreziqet e rrezatimit optik dhe përdorimin e masave mbrojtëse, të informojnë të punësuarit për rrezikun dhe masat parandaluese në vendin e punës.

4. Monitorimi dhe kontrolli i ekspozimit: Të kryejnë matje dhe monitorime periodike të niveleve të rrezatimit, të mbajnë regjistra të ekspozimeve dhe të veprojnë në rast të tejkalimit të kufijve të ekspozimit.





5. Mbrojtja e grupeve të ndjeshme: Të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë shtatzëna, të miturit dhe punëtorët me sëmundje ose ndjeshmëri ndaj rrezatimit.

6. Bashkëpunimi me autoritetet kompetente: Të respektojnë legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe të bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse për inspektime dhe vlerësime.

PËRCAKTIMI I EKSPOZIMIT DHE VLERËSIMI I RISKUT NGA PUNËDHËNËSI

Sipas legjislacionit përkatës, punëdhënësi është i detyruar të bëjë një vlerësim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm të riskut për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve nga rrezatimi optik, si artificial ashtu edhe natyror. Ky vlerësim synon të identifikojë masat që duhet të merren për të minimizuar ekspozimin dhe rreziqet e mundshme.

- 1. Vlerësimi i riskut:** Punëdhënësi duhet të kryejë një vlerësim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm të riskut për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve nga rrezatimi optik, artificial dhe natyror. Vlerësimi identifikon masat që duhet të merren për mbrojtjen e të punësuarëve. Burimet e rrezatimit artificial mund të krijojnë ekspozim të rrezikshëm në vendin e punës dhe më pas vlerëson nivelin e ekspozimit, duke u bazuar në elementet e mëposhtme:
 - Matja e nivelit të rrezatimit optik, siç është e përcaktuar në Rregulloren (MPMS), Nr.09/2017 për mbrojtjen e të punësuarëve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës;
 - Të dhënat e siguruara nga prodhuesi mbi nivelin e rrezatimit të një pajisje të caktuar (kategoria e emetimit të pajisjes në përputhje me standardin EN 12198-1), llampa/sistemi i llampës (grupi i riskut në përputhje me standardin IEC/EN 62471) ose klasën e Laserit sipas standardit IEC/EN 60825.
 - Llogaritja e nivelit të rrezatimit, kur është e mundur të kryhet.
- 2. Punëdhënësi siguron vlerësimin e niveleve të ekspozimit:** Ky vlerësim kryhet kur është e mundur, duke marrë parasysh të gjitha aktivitetet me burimet e rrezatimit (vendosja në punë, shërbimi, mirëmbajtja etj.). Intervallet e matjes përcaktohen në bazë të nivelit të ekspozimit krahasuar me Vlerat Kufi të Ekspozimit (VKE).
- 3. Metodrat dhe aparaturat** e përdorura për vlerësimin e riskut duhet të jenë në përputhje me standardet aktuale evropiane dhe/ose ndërkombëtare siq janë:
 - **IEC/EN 60825-1** (Përcakton metodat e klasifikimit dhe matjes së rrezatimit lazer për qëllime sigurie);
 - **EN 14255-1, EN 14255-2, EN 14255-3**, (Përcaktojnë metodat për matjen dhe vlerësimin e ekspozimit ndaj rrezatimit optik artificial (jo-koherent dhe lazer);
- 4. Vlerësimi, matja dhe llogaritjet** e përmendura më lartë dhe vlerësimi i riskut planifikohen dhe zhvillohen nga shërbime ose persona të specializuar sipas legjislacionit përkatës.
- 5. Matjet dhe vlerësimi i riskut për burimet e rrezatimit optik artificial jo koherent:** Matjet kryhen një herë në vit ose një herë në dy vjet, në varësi të raportit NE/VKE. Mund të shmangen matjet shpesh nëse dy matjet e fundit tregojnë nivel të ulët të ekspozimit dhe nuk ka ndryshime në vendin e punës.
- 6. Matjet dhe vlerësimi i riskut për burimet artificiale të rrezatimit Laser:** Varen nga niveli i matur i ekspozimit (NE) në lidhje me Vlerën Kufi të Ekspozimit, të cilat kryhen në intervale kohore si më poshtë:
-të paktën një herë në vit, nëse vlerat janë: $0.7 VKE < NE \leq VKE$



-të paktën një herë në dy vjet, nëse vlerat janë $0.4 VKE < NE \leq VKE$.

7. **Matjet dhe vlerësimet e riskut për burimet artificiale të rrezatimit Laser** varen nga niveli i matur i ekspozimit (NE) në lidhje me Vlerën Kufi të Ekspozimit (VKE), të cilat kryhen në intervale kohore:
- Të paktën një herë në vit, nëse vlerat janë $0.8 VKE < NE \leq VKE$;
 - Të paktën një herë në dy vjet, nëse vlerat janë $0.4 VKE < NE \leq 0.8 VKE$.

Punëdhënësi mund të kryejë matje të tjera edhe kur dy matjet e fundit japin vlerat $NE \leq 0.4 VKE$, në rastet kur ka pasur ndryshime në vendin e punës, të cilat mund të ndikojnë në nivelin e ekspozimit.

Dokumentimi i vlerësimit përfshin: Identifikimin e agjentëve të rrezikshëm, të dhënat mbi nivelin e ekspozimit, vendndodhjen e punës së vlerësuar, emrin e personit ose shërbimit të specializuar që ka kryer vlerësimin, metodën e përdorur dhe interpretimin e rezultateve.

Faktorët që duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit: Niveli, gjatësi vale dhe kohëzgjatja e ekspozimit. Ekspozimi ndaj rrezatimit natyror dhe artificial, vlerat kufi të ekspozimit (VKE), efektet për grupet e ndjeshme (gratë shtatzëna, të miturit, përdoruesit e substancave fotosensitive), efektet indirekte, si verbimi i përkohshëm, rreziku nga zjarri ose shpërthimi, burimet alternative dhe informacioni i siguruar nga mbikëqyrja shëndetësore.

Rivlerësimi i riskut: Kryhet kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në vendin e punës ose në rrethana që mund të ndryshojnë nivelin e ekspozimit, rivlerësimi bëhet gjithashtu sipas nevojës që evidenton mbikëqyrja shëndetësore.

SHMANGIA OSE ZVOGËLIMI I EKSPOZIMIT

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të riskut, punëdhënësi përcakton veprimet teknike dhe organizative të nevojshme për të zvogëluar risqet që krijohen nga ekspozimi ndaj rrezatimit optik. Nëse vlerësimi i riskut tregon se ekspozimi ndaj rrezatimit optik artificial mund të tejkalojë Vlerat Kufi të Ekspozimit (VKE), punëdhënësi duhet të hartojë dhe zbatojë një plan veprimi me masa për të parandaluar ose zvogëluar ekspozimin. Ky plan duhet të përfshijë:

- ❖ përdorimin e metodave të tjera pune që ulin rrezikun nga rrezatimi optik;
- ❖ pajisje që emetojnë më pak rrezatim optik dhe masa teknike si ekrane, bllokim apo fikje automatike;
- ❖ mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve dhe hapësirave të punës;
- ❖ organizim të vendit të punës për të kufizuar kohën dhe nivelin e ekspozimit;
- ❖ pajisje mbrojtëse personale dhe ndjekjen e udhëzimeve të prodhuesit.

Vendet e punës ku ekspozimi ndaj rrezatimit optik mund të kalojë kufijtë duhet të jenë të sinjalizuara qartë dhe kur është e mundur, të kufizohet qasja në to. Punëtorët nuk duhet të ekspozohen mbi Vlerat Kufi të Ekspozimit, në rast tejkallimi, punëdhënësi duhet të:

- ❖ ndërmarrë masa të menjëhershme për uljen e ekspozimit nën Vlerat Kufi të Ekspozimit;
- ❖ identifikojë arsyet e tejkallimit të Vlerave Kufi të Ekspozimit dhe
- ❖ përshtatë masat mbrojtëse për të parandaluar përsëritjen.



Gjithashtu, kur ekspozimi vjen nga burime natyrore, duhet hartuar një plan për zvogëlimin e riskut dhe për grupet e ndjeshme (p.sh. gra shtatzëna, të mitur), masat duhet të jenë të përshtatura posaçërisht.

Shenjat paralajmëruese duhet të jenë në përputhje me **standardin EN ISO 7010** dhe të vendosen në çdo zonë ku ekspozimi mund të kalojë Vlerat Kufi të Ekspozimit (VKE).

INFORMIMI DHE TRAJNIMI I TË PUNËSUARËVE

Punëdhënësi, në përputhje me legjislacionin përkatës, duhet të sigurojë që të punësuarit e ekspozuar ndaj rrezatimit optik të marrin informim dhe trajnim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për mbrojtjen e tyre.

Trajnimi dhe informimi duhet të përfshijnë:

- ❖ Masat që janë ndërmarrë për zbatimin e rregullores për mbrojtjen nga rrezatimi optik;
- ❖ Vlerat Kufi të Ekspozimit (VKE) dhe rreziqet e mundshme që lidhen me to;
- ❖ Rezultatet e vlerësimit të riskut për vendet e punës, përfshirë: matjet apo llogaritjet e ekspozimit dhe shpjegimin e tyre;
- ❖ Mënyrën e identifikimit dhe raportimit të efekteve negative të ekspozimit në shëndet;
- ❖ Rastet kur punëtorët kanë të drejtë për kontroll shëndetësor periodik;
- ❖ Praktikrat e sigurta të punës për të reduktuar ekspozimin;
- ❖ Përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse (syze mbrojtëse, mburoja, veshje të posaçme etj.).

💡 Shembull praktik:

Në një punëtori ku përdoren pajisje saldimi që emetojnë rrezatim ultravjollcë (UV), punëdhënësi duhet të:

- ❖ informojë punëtorët për rrezikun që ky rrezatim mund të shkaktojë dëmtime të syve dhe lëkurës;
- ❖ t'u tregojë si të përdorin maskat mbrojtëse dhe syzet e përshtatshme;
- ❖ t'i trajtojë se si të njohin shenjat e ekspozimit të tepërt (si irritimi i syve ose djegiet në lëkurë) dhe si t'i raportojnë menjëherë.



Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarve

Në përputhje me legjislacionin përkatës, punëdhënësi duhet të sigurojë masa të përshtatshme për konsultimin dhe përfshirjen e punëtorëve në çështjet që lidhen me vlerësimin e riskut dhe me masat parandaluese që ndërmerren për të shmangur ose reduktuar ekspozimin ndaj rrezatimit optik.

Kjo do të thotë që punëdhënësi nuk duhet të marrë vendime në mënyrë të njëanshme, por të përfshijë të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre në procesin e identifikimit të burimeve të rrezatimit, vlerësimit të ekspozimit dhe në përcaktimin e mënyrave më të sigurta të punës.



💡 Shembull praktik:

Në një kompani që përdor pajisje lazer për prerje metali, punëdhënësi zhvillon një takim konsultues me punëtorët dhe personin përgjegjës për siguri dhe shëndet në punë, për të diskutuar rezultatet e vlerësimit të riskut. Gjatë takimit, punëtorët japin sugjerime për vendosjen e mburojave shtesë mbrojtëse dhe për rregullimin e orareve të punës në mënyrë që të kufizohet ekspozimi. Këto sugjerime merren parasysh dhe përfshihen në planin e masave të sigurisë.

Mbikëqyrja shëndetësore

Për të parandaluar dhe zbuluar në kohë çdo ndikim negativ në shëndet si pasojë e ekspozimit ndaj rrezatimit optik, si dhe për të shmangur risqet afatgjata apo mundësinë e zhvillimit të sëmundjeve kronike, punëdhënësi është i detyruar të sigurojë mbikëqyrje shëndetësore për çdo të punësuar që ekspozohet ndaj këtij lloji rrezatimi, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Kontrollet mjekësore duhet të jenë të përshtatura me llojin dhe spektrin e rrezatimit optik.

Nëse një i punësuar raporton efekte të dëmshme ose të papritura në shëndet, ose kur konstatohet tejkalim i vlerave kufi të ekspozimit, punëdhënësi duhet të organizojë ekzaminime mjekësore të posaçme për punëtorët në fjalë, sipas rregullave për mbikëqyrje shëndetësore.

Në rastet kur nga mbikëqyrja shëndetësore konstatohet se një punëtor vuan nga sëmundje apo pasoja shëndetësore që lidhen me ekspozimin ndaj rrezatimit optik, punëdhënësi duhet të ndërmarrë masat përkatëse mjekësore dhe parandaluese. Mjeku i punës, kur e konsideron të nevojshme, mund të konsultohet me specialistë të fushës për vlerësim më të thelluar.

Në të gjitha rastet e përmendura më sipër, kur konstatohen efekte negative ose tejkalim i vlerave kufi: **Punëtori** njoftohet nga mjeku i punës për rezultatet që lidhen me shëndetin e tij personal dhe këshillohet për monitorimin shëndetësor pas ekspozimit; **Punëdhënësi** informohet për gjetjet e rëndësishme të mbikëqyrjes shëndetësore, duke respektuar konfidencialitetin mjekësor.

Në këto raste, punëdhënësi është i detyruar të: rishikojë vlerësimin e riskut; përditësojë masat parandaluese për shmangien ose reduktimin e risqeve, marrë parasysh këshillat e mjekut të punës, ekspertëve të sigurisë apo autoriteteve kompetente për përmirësimin e kushteve të punës, sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme shëndetësore për punëtorët e prekur dhe nëse është e nevojshme, për të gjithë të punësuarit që kanë qenë të ekspozuar në mënyrë të ngjashme.

Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore dokumentohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin për shëndetin në punë dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Punëtori me kërkesë ka të drejtë të ketë qasje në të dhënat e tij shëndetësore në çdo kohë.



Shembull praktik: Në një kompani që përdor burime të rrezatimit optik artificial (si lazerë për prerje materiali), punëtorët që punojnë drejtpërdrejt me këto pajisje i nënshtrohen kontrolleve mjekësore periodike për të verifikuar nëse ka ndryshime në shikim apo në lëkurë. Nëse një i punësuar raporton acarim të syve ose ndjeshmëri ndaj dritës, ai dërgohet për ekzaminim shtesë, ndërsa punëdhënësi rishikon masat mbrojtëse, p.sh. përmirësimin e mburojave optike ose ndryshimin e orarit të punës për të kufizuar ekspozimin.



MASAT EMERGJENTE NË RAST TË EKSPOZIMIT AKSIDENTAL NDAJ RREZATIMIT OPTIK

Punëdhënësi është i detyruar të ndërmarrë menjëherë masa për të ulur ekspozimin nën Vlerat Kufi të Ekspozimit (VKE) dhe për të parandaluar përsëritjen e ngjarjeve të ngjashme. Në rast të ekspozimit aksidental apo tejkallimit të vlerave kufi, duhet ndërmarrur veprimet e mëposhtme:

Ndërprerja e menjëhershme e burimit të rrezatimit: Burimi i rrezatimit (lazeri, llampa UV, pajisje infra të kuqe etj.) duhet të fiket ose izolohet menjëherë dhe zona e ekspozimit duhet të mbyllet për të parandaluar qasjen e personave të tjerë.

Informimi i menjëhershëm i personit përgjegjës për siguri dhe shëndet në punë dhe i mbikëqyrësit të punës: Punëmarrësi i ekspozuar duhet të njoftojë menjëherë personin përgjegjës për siguri dhe shëndet në punë, përfaqësuesin e punëtorëve ose menaxherin përkatës dhe punëdhënësi është i detyruar të fillojë menjëherë hetimin e incidentit dhe të verifikojë arsyet e tejkallimit të ekspozimit.

Dërgimi për ekzaminim mjekësor: Punëtori i ekspozuar duhet t'i nënshtrohet menjëherë kontrollit shëndetësor nga **mjeku i punës**, për të vlerësuar efektet e mundshme në sy dhe lëkurë.

Nëse konstatohet ndonjë ndikim negativ, mjeku i punës duhet të rekomandojë masa mjekësore dhe kohë pushimi, sipas gjendjes së punëtorit.

Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë që këto ekzaminime të kryhen pa kosto financiare për punëtorët.

Dokumentimi i incidentit në regjistrin e aksidenteve dhe masat korrigjuese: Çdo rast i ekspozimit aksidental duhet të regjistrohet në regjistrin e aksidenteve në punë.

Punëdhënësi duhet të analizojë shkaqet dhe të përditësojë vlerësimin e riskut dhe masat parandaluese në përputhje me rezultatet e analizës.

Rishikimi i masave parandaluese dhe trajnimeve: Pas çdo incidenti, duhet të rishikohet procedura e sigurisë për rrezatimin optik dhe të organizohet trajnim shtesë për punëtorët, në mënyrë që të parandalohen raste të ngjashme.



💡 Shembull praktik:

Në një punëtori ku përdoret lazer për prerje materiali, një punëtor raporton shqetësim në sy pas një dështimi të mburojës optike. Pajisja ndalet menjëherë, punëtori dërgohet për kontroll oftalmologjik, incidenti regjistrohet në librin e aksidenteve dhe mburojat kontrollohen për defekte. Si masë parandaluese, punëdhënësi vendos mburoja shtesë dhe përsërit trajnimin për përdorim të sigurt të lazerit.

DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË TË PUNËSUARËVE PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMI OPTIK

Punëtorët kanë përgjegjësi aktive për të kontribuar në mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të tyre nga rrezatimi optik në vendin e punës. Këto detyrime përfshijnë:

Respektimi i masave mbrojtëse:

- Të përdorin pajisjet personale mbrojtëse të siguruar nga punëdhënësi, si syze, rroba ose mburoja për lëkurën.
- Të ndjekin udhëzimet dhe procedurat e vendosura për të reduktuar ekspozimin ndaj rrezatimit optik.



Përdorimi i pajisjeve dhe mjetëve në mënyrë të sigurt

- Të operojnë pajisjet që prodhojnë rrezatim optik sipas udhëzimeve të sigurisë.
- Të mos modifikojnë pajisjet ose të shmangin masat mbrojtëse teknike pa autorizim.

Informimi i menaxhmentit

- Të raportojnë çdo situatë që mund të rrisë rrezikun e ekspozimit ndaj rrezatimit optik.
- Të njoftojnë për defekte në pajisjet mbrojtëse ose shkelje të procedurave të sigurisë.

Pjesëmarrja në trajnimet dhe udhëzimet e sigurisë

- Të marrin pjesë në trajnime të organizuara për njohjen dhe parandalimin e rreziqeve nga rrezatimi optik.
- Të njohin dhe kuptojnë rreziqet dhe masat mbrojtëse për vendin e tyre të punës.



Bashkëpunimi për zbatimin e masave të sigurisë

- Të respektojnë rregullat dhe procedurat e vendosura nga punëdhënësi.
- Të japin kontribut në krijimin e një ambienti pune të sigurt për të gjithë të punësuarit.

PËRFUNDIMI

Ky udhëzues përbën një dokument të rëndësishëm për zbatimin e kërkesave të Rregullores (MPMS) Nr. 09/2017 “Për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës”, i cili synon të garantojë mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve nga efektet e mundshme të rrezatimit optik artificial dhe natyror. Ai ofron një kornizë të qartë për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut që buron nga burimet e rrezatimit optik. Ky udhëzues nuk është vetëm një dokument teknik apo ligjor, por një mjet praktik i menaxhimit të riskut, që ndihmon në ngritjen e një kulture të qëndrueshme të sigurisë në vendin e punës. Përmes zbatimit të vazhdueshëm të procedurave, matjeve të rregullta, mbikëqyrjes shëndetësore, dhe përditësimit të masave parandaluese, punëdhënësi garanton një mjedis pune më të sigurt, ndërsa punëtorët mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Punëdhënësit, ekspertët e sigurisë, mjekët e punës dhe vetë punëtorët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për zbatimin efektiv të masave parandaluese, monitorimin e ekspozimit dhe raportimin e rregullt të çdo devijimi nga standardet e përcaktuara. Vetëm përmes një angazhimi të tillë të përbashkët mund të garantohet mbrojtja afatgjatë e shëndetit, rritja e produktivitetit dhe përmbushja e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

AUDITIME

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive sigurinë dhe shëndetin në punë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mbani mend: Rreziqet e rrezatimit optik mund të gjenden në të gjitha llojet e vendeve të punës. Ju mund të zvogëloni ose eliminoni ato rreziqe duke i identifikuar ato, duke vendosur masa të përshtatshme kontrolli për të mbajtur të sigurt punëtorët tuaj, duke komunikuar me ta dhe duke mbështetur ata.



SHTOJCA1: SHEMBUJ TË FAKTORËVE TË RREZIKUT NGA RREZATIMI OPTIK

Si pjesë e procesit të vlerësimit të riskut të rrezatimit optik, do të jetë e nevojshme të identifikohen faktorët e rrezikut që janë të rëndësishëm për një detyrë të veçantë. Informacioni i mbledhur më pas mund të përdoret për të identifikuar se çfarë përmirësimesh mund të vendosen për të mënjeluar ose zvogëluar rreziqet nga rrezatimi optik.

FAKTORËT E RREZIKUT	PO	JO	KOMENT
A bëhet vlerësimi i nivelit të ekspozimit?			
A është në disponim dokumenti i vlerësimit të ekspozimit tek punëmarrësit?			
A identifikon vlerësimi i riskut masat të cilat duhet të ndërmerren?			
A planifikohet dhe a realizohet vlerësimi i riskut dhe matja e burimeve të rrezatimit sipas legjislacionit në fuqi?			
A kryhen matjet dhe vlerësimi i riskut për burimet e rrezatimit artificial optik jo-koherent dhe/ose burimet artificiale të rrezatimit laser, në intervale një herë në vit ose një herë në çdo dy vjet në varësi të nivelit të ekspozimit në raport me Vlerën Kufi të Ekspozimit?			
A ndalohet puna e të miturve?			
A është siguruar që niveli i ekspozimit për gratë shtatzëna të mos tejkalojë $\frac{1}{4}$ e Vlerës Kufi të Ekspozimit për rrezatimin artificial ultravjollcë?			
A janë metodat dhe aparaturat e përdorura për vlerësimin e riskut në përputhje me standardet aktuale evropiane dhe/ose ndërkombëtare?			
A janë përcaktuar veprimet e nevojshme teknike dhe organizative për të reduktuar rreziqet që vijnë nga ekspozimi 4 ndaj rrezatimit optik, në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut?			
A janë vendosur shenjat në vendet e punës ku punëmarrësit mund të ekspozohen ndaj niveleve të rrezatimit optik nga burime artificiale që tejkalojnë vlerat kufi të ekspozimit?			
A është hartuar dhe a zbatohet një plan veprimi i cili përfshin masa teknike dhe organizative, nëse vlerësimi i riskut tregon një risk për			



punëmarrësit e ekspozuar ndaj burimeve natyrore të rrezatimit optik?			
A bëhet konsultimi dhe pjesmarrja e të punësuarve në përputhje me legjislacionin përkatës?			
A është siguruar një mbikëqyrje shëndetësore periodike për ata punëmarrës që janë potencialisht të ekspozuar?			
A është objekti i kontrolleve mjekësore i përshtatshëm me llojin dhe brezin e rrezatimit optik, të përcaktuar në Shtojcën III të rregullores Nr.09/2017?			
A regjistrohen të dhënat nga mbikëqyrja shëndetësore për çdo punëmarrës në një formë të përshtatshme, që lejon konsultimin e tyre në një fazë të mëvonshme?			